



PROGRAMI I LËNDËS 2023-2024

Variantet e Gjuhës B

Titullari /pedagogu i lëndës (për programet profesionale): Prof.Dr. Daniela Tamo, Dr. Daniela Hasa, Dr. Fatma Shijaku

Ngarkesa: 4 ECTS, 20 orë leksione, 20 orë seminare

Viti akademik, semestri kur zhvillohet: Viti II, semestri 2

Lloji i lëndës: e detyrueshme

Programi i studimit: Gjuhë Angleze

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: daniela.tamo@unitir.edu.al, daniela.hasa@unitir.edu.al, fatma.shijaku@unitir.edu.al

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 5 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT: Moduli “Variantet e Gjuhës B” është pjesë e programit trevjeçar Bachelor të formimit të studentëve të gjuhës angleze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës. Kjo lëndë synon trajtimin e njohurive bazë të variacionit gjuhësor të gjuhës angleze sipas fushave të ndryshme studimore të gjeografisë gjuhësore, sociolinguistikës, etj. dhe disiplinave gjuhësore të semantikës, fonetikës, gramatikës, etj. në një prerje kryesisht sinkronike duke trajtuar edhe disa të dhëna lidhur me zhvillimin diakronik të variacionit gjuhësor të gjuhës angleze dhe tipareve kulturore që lidhen me të.

Objektivat e kursit:

Objektivat kryesore të kësaj lënde janë:

- t’u japë studentëve njohuritë kryesore në lidhje me variantet e gjuhës angleze dhe variancionin gjuhësor sipas teorive të gjeografisë gjuhësore, sociolinguistikës, etj. dhe sipas disiplinave të ndryshme gjuhësore, leksikore, sematike, gramatikore, fonetike, ortografike, etj.,
- të ndihmojë në aftësimin e studentëve për përdorimin e drejtë të varianteve të gjuhës angleze.
- t’u paraqesë dhe të nxisë tek studentët domosdoshmërinë e përdorimit të fjalorëve dhe teksteve të ndryshme sipas varianteve kryesore të gjuhës angleze për t’i përgatitur ata drejt një pune të pavarur në lidhje me zgjerimin dhe përvetësimin e gjuhës angleze sipas varianteve të shumta dhe variacionit gjuhësor

Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do të jenë të aftë të:

- kenë një njohje të mirë të variacionit gjuhësor dhe kulturor me të cilën lidhet zhvillimi dhe përdorimi i gjuhës angleze;

- kenë një njohje të mirë të ndryshimeve semantike, leksikore, gramatikore, fonetike dhe stilistikore midis anglishtes britanike dhe amerikane, si dhe të varianteve të tjera të gjuhës angleze;

- kanë një panoramë më të gjerë për kulturën dhe shoqërinë britanike dhe amerikane, australiane, etj. sipas dallimeve gjuhësore të trajtuara;
- përmirësojnë nivelin e tyre të përvetësimit të gjuhës në tërësinë e varianteve të gjuhës angleze; analizojnë tekste, pjesëza dëgjimore të ndryshme britanike, amerikane, etj. sipas veçorive gjuhësore.